

<b>SYLLABUS (PLANPROGRAM MËSIMOR)</b>	
<b>Ëësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>BAZAT E SISTEMIT GJYQËSOR</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Studimet Themelore (Bachelor)</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore (Z)</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i I-rë – semestri i I-rë</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>09:00 – 10:30 / A4</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Mr. sc. Vigan QORROLI, PhD (c)</b>
<b>E-maili kontaktues:</b>	<b>vigan.qorrolli@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Lënda <b>Bazat e Sistemit Gjyqësor</b> për studentët e studimeve themelore është projektuar me qëllim që të rrisë nivelin e aftësive dhe të njohurive për sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Si lëndë zgjedhore – kjo lëndë në të njëjtën kohë shërben edhe si një hyrje për lëndët e tjera në kuadër të plan-programit mësimor të Fakultetit Juridik, në veçanti me lëndët që kanë për objekt studimi çështjet procedurale, si procedura administrative, procedura civile, procedura penale, si dhe çështje të së drejtës kushtetuese.</p> <p>Aktiviteti në ligjërata dhe ushtrime është i domosdoshëm për çdo student. Ata janë të obliguar t'i diskutojnë me bartësin e lëndës temat e diskutuara që do të trajtohen pas një konsultimi paraprak.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kësaj lënde është që t'u mundësojë studentëve – të fitojnë njohuri të thelluara në Bazat e Sistemit Gjyqësor të Kosovës – në mënyrë që ata më pas mund t'i aplikojnë dhe reflektojnë në vijim të studimeve të tyre për drejtësi.</p> <p>Për më tepër, me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentet do të kenë mundësi dhe aftësi për të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) [...] identifikuar dhe analizuar legjislacionin në fuqi, me të cilin janë vënë bazat e përgjithshme të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës;</li> <li>2) [...] kuptuar parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor si dhe rëndësinë dhe efektin e këtyre parimeve në punën e gjykatave në zbatimin e Kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative në përgjithësi;</li> <li>3) [...] njohur mënyrën e rregullimit dhe të dallimit në mes të strukturës organizative dhe kompetencave të</li> </ol>

	<p>gjykatave sipas Ligjit për Gjykatat të vitit 1978 (Gjykatës për Kundërvajtje, Gjykatës Komunale, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike dhe Gjykatës Supreme) dhe strukturës organizative dhe kompetencat e gjykatave sipas Ligjit për Gjykatat të vitit 2010 (Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme);</p> <p>4) [...] njohur mënyrën e rregullimit dhe të jetë në gjendje të bëjë dallimin në mes të strukturës organizative të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë;</p> <p>5) [...] kuptuar rolin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës – pra rolin mbikëqyrës në funksionimin e gjykatave, përgjegjësit e tij për të siguruar një pushtet gjyqësor unik, të pavarur, të drejtë, apolitik e të paanshëm dhe qasje të barabartë për të gjithë qytetarët në gjykata si dhe për përgjegjësin për përcaktimin e politikave dhe strategjive për funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave;</p> <p>6) [...] kuptuar rolin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës – pra rolin mbikëqyrës në funksionimin e prokurorive, përgjegjësit e tij për të siguruar një pushtet prokurorial unik, të pavarur, të drejtë, apolitik e të paanshëm si dhe të sigurojë qasje të barabartë për të gjithë qytetarët;</p> <p>7) [...] njohur procedurat, themelimin, organizimin dhe funksionimin si dhe për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e sitemit të noterisë, avokatisë dhe të ndërmjetësimit;</p> <p>8) [...] kuptuar marrëveshjet e arbitrazhit, procedurat para arbitrazhit si dhe njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit të nxjerra brenda dhe jashtë Kosovës.</p>		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studentët e Fakultetit Juridik do t'i:</p> <p>1. Avancojnë njohuritë e saj/tij në të kuptuarit e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës;</p>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsejt</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	/	/	/
Punë praktike	1	15	15

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	7	7
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiime,seminare	1	1	2
Detyra të shtëpisë	1	1	2
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1	3
Projektet,prezentimet ,etj	15 min	6	2
<b>Totali</b>			<b>104 ore</b>

**Metodologjia e mësimdhënies:**

Për të arritur objektivat e paraqitura më lartë, në kuadër të kësaj lënde, përveç ligjërimit dhe përfshirjes aktive të studentëve në diskutimin dhe shtjellimin e çështjeve me interes të veçantë, një rol kyç do të luajë:

1. puna e studentëve në grupe me qëllim të interpretimit dhe analizimit të dispozitave ligjore, me të cilin janë vënë bazat e përgjithshme dhe të veçanta për organizimin e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës;
2. studimi i rasteve konkrete që kanë të bëjnë me procedurat për rekrutimin, kushtet për emërimin dhe rrimërimin si dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve
3. krahasimi dhe analizimi i strukturës organizative dhe kompetencave të gjykatave, rolit dhe përgjegjësisë të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, çështjeve të ndërmjetësimit, të noterisë, si dhe veprimtarisë së Avokatisë në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovës;
4. ushtrimet praktike mbi parimet themelore, subjektet, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë, llojet e kompetencave si dhe mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme (në procedurën penale dhe procedurën civile);
5. hulumtimet, analizat, punimet seminarike si dhe prezantimet e studentëve, nga të cilat do të gjenerohen debate, opinione, rekomandime dhe konkluzione në mes të tyre.

Për qëllime të mësimdhënies, metoda të ndryshme mësimore mund të përdoren bashkë me mjete ndihmëse, si, psh. vizita studimore, puna e përbashkët kërkimore, trajnimet në shtëpi, etj.

<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p>Një kombinim i metodologjive të ndryshme të vlerësimit do të përdoret për të vlerësuar studentët në harmoni me objektivat, qëllimet dhe rezultatet e pritura për studentët. Në këtë mënyrë, sigurisht do të akomodohen interesat reciproke të profesorit të lëndës me ato të studentëve – me qëllim të arritjes së rezultateve maksimale.</p> <p>Në parim, është e rekomandueshme për çdo javë të bëhen analiza/komente për çështje të diskutuara në klasë javën paraprake.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjërata, ushtrime dhe debate – vlerësohet me 10 përqind (%)</li> <li>2. Pjesëmarrja aktive në punën e studentëve në grupe, studimin e rasteve konkrete dhe në prezantimin e punimeve – vlerësohet me 10 përqind;</li> <li>3. Vlerësimi i parë - me 20 përqind;</li> <li>4. Vlerësimi i dytë – me 20 përqind</li> <li>5. Vlerësimi i përfundimtar – gjithsej 40 përqind.</li> </ol> <p>Do të ketë një provim përfundimtar – pjesa kryesore e vlerësimit – që do të mbulojë materialet e detyrueshme për lexim, si shtesë e asaj që është thënë në ligjërata. Nota do të varet në vlerën prej 40 për qind (%) nga ky provim.</p> <p>Për pjesën tjetër të vlerësimit (60%), studentët do të duhet të jenë të vetëdijshëm se ajo varet nga vlerësimi dhe është në dorë të profesorit të tyre – rreth aktivitetit në klasë të studentëve dhe pjesëve të tjera të performancës së tyre të përshkruara më lartë, gjatë semestrit të parë.</p>
<p><b>Literatura</b></p>	
<p><b>Literatura bazë:</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Material i hartuar nga ligjëruesi për studentët,</li> <li>2. Azem Hajdari, <i>Bazat e Sistemit Gjyqësor</i>, 2013;</li> <li>3. “Ri-themelimi dhe Reformimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë 1999 – 2011”, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, maj 2011, Prishtinë.</li> </ol>
<p><b>Literatura shtesë:</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës</li> <li>2. Ligji për Gjykatat</li> <li>3. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës</li> <li>4. Ligji për Prokurorin e Shtetit</li> <li>5. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës</li> <li>6. Ligji për Ndërmjetësim</li> <li>8. Ligji për Noterinë</li> </ol>

	<p>9. Ligji për Avokatinë</p> <p>10. Veprimi i Përbashkët i Këshillit për Misionin e Sundimit të Ligjit (EULEX) në Kosovë, Bruksel, 4 shkurt, 2008, si dhe amendamenti i tij përmes Vendimeve të Këshillit 2009/445, 2010/322, 2012/291, 2014/349, dhe 2016/947.</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e Parë:</b>	<p><b>HYRJE</b></p> <p>Përmbajtja e lëndës, metoda, organizimi dhe kërkesat e lëndës</p>
<b>Java e Dytë:</b>	<p><b>NDARJA E PUSHTETEVE NË KOSOVË (SISTEMI KUSHTETUES)</b></p> <p>Organizimi, pavarësia e tyre dhe kontrolli reciprok midis pushteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Historiku shkurtër i sistemit të drejtësisë në Kosovë</li> <li>• Vendosja e UNMIK-ut dhe "Sistemit Emergjent i Drejtësisë" (qershor – dhjetor 1999 dhe janar 2000 – maj 2001)</li> <li>• Sistemi i drejtësisë në kuadër të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (maj 2001 – shkurt 2008)</li> <li>• Sistemi i drejtësisë në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës</li> <li>• Parimet e përgjithshme të Sistemit të Drejtësisë në Republikën e Kosovës</li> <li>• Burimet juridike të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.</li> </ul>
<b>Java e Tretë:</b>	<p><b>GJYQËSORI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS (GJYKATAT)</b></p> <p>Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i gjykatave në Republikën e Kosovës sipas Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat</p> <p>- Struktura organizative e <b>Gjykatave Themelore:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Organizimi i brendshëm dhe ndarja e kompetencave territoriale e Gjykatave Themelore dhe të degëve të Gjykatave Themelore</li> <li>b) Kompetenca lëndore dhe territoriale e departamentit për Çështje Ekonomike</li> <li>c) Kompetenca lëndore dhe territoriale e departamentit për Çështje Administrative</li> <li>d) Kompetenca lëndore dhe territoriale e departamenteve për Krimet e Rënda</li> <li>e) Kompetenca lëndore dhe territoriale e departamenteve të përgjithshme</li> </ol>

	<p>f) Kompetenca lëndore dhe territoriale e departamenteve për të Mitur</p> <p>- Struktura organizative e <b>Gjykatës së Apelit</b></p> <p>a) Organizimi i brendshëm e Gjykatës së Apelit</p> <p>b) Kompetenca lëndore dhe territoriale e Gjykatës së Apelit</p> <p>- Struktura organizative, funksionimi dhe kompetencat e <b>Gjykatës Supreme</b></p> <p>a) Jurisdiksioni dhe organizimi i Gjykatës Supreme</p>
<b>Java e Katërt:</b>	<p><b>KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përbërja dhe zgjedhja/emërimi i anëtarëve të KGJK-së</li> <li>• Zgjedhja, detyrat dhe përgjegjësit e Kryesuesit dhe Zëvendës-kryesuesit të KGJK</li> <li>• Detyrat dhe përgjegjësit e KGJK-së</li> <li>• Kriteret dhe kualifikimet për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit;</li> </ul>
<b>Java e Pestë:</b>	<p><b>GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SE KOSOVËS</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Gjykatës Kushtetuese</li> <li>• Kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese</li> <li>• Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese</li> <li>• Palët e autorizuara që mund të fillojnë procedurën para Gjykatës Kushtetuese</li> <li>• Mënyra e marrjes së vendimeve nga Gjykata Kushtetuese</li> <li>• Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese</li> </ul>
<b>Java e Gjashtë:</b>	<p><b>DREJTËSIA PENALE NË REPUBLIKËN E KOSOVES</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuritë e përgjithshme për procedurën penale</li> <li>• Parimet themelore në procedurën penale</li> <li>• Pjesëmarrësit (subjektet) në procedurën penale</li> <li>• Mjetet juridike në procedurën penale</li> <li>• Mjetet e rregullta juridike</li> <li>• Mjetet e jashtëzakonshme në procedurën penale</li> </ul>
<b>Java e Shtatë:</b>	<p><b>Vleresimi i parë (test mes-semestral)</b></p>
<b>Java e Tetë:</b>	<p><b>DREJTËSIA CIVILE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuritë e përgjithshme në procedurën civile</li> <li>• Dallimi në mes të procedurës kontestimore, jokontestimore dhe përmbartimore</li> <li>• Parimet themelore në procedurës kontestimore, jokontestimore dhe përmbartimore</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrësit (subjektet) në procedurën kontestimore, jokontestimore dhe përbarimore</li> <li>• Mjetet juridike në procedurën kontestimore</li> <li>• Mjetet e rregullta</li> <li>• Mjetet e jashtëzakonshme</li> </ul>
<b>Java e Nëntë:</b>	<p><b>SISTEMI PROKURORIAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b></p> <p>Historiku: Organizimi, funksionimin dhe kompetencat e sistemit prokurorial në Kosovë deri më 1 janar 2013</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e sistemit prokurorial në Kosovë pas 1 janarit 2013;</li> <li>• Organizimi, funksionimi, përbërja dhe kompetencat e Prokurorive Themelore;</li> <li>• Organizimi, funksionimi, përbërja dhe kompetencat e Prokurorisë së Apelit;</li> <li>• Organizimin, funksionimin, përbërja dhe kompetencat e Prokurorisë Speciale;</li> <li>• Organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.</li> </ul>
<b>Java e Dhjetë:</b>	<p><b>KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS (KPK)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK)</li> <li>• Përbërja dhe zgjedhja/emërimi i anëtarëve të KPK-së</li> <li>• Detyrat dhe përgjegjësit e Kryesuesit dhe (zgjedhja) Zëvendës-kryesuesit të KPK</li> <li>• Detyrat dhe përgjegjësit e KPK-së</li> </ul>
<b>Java e Njëmbëdhjetë:</b>	<p><b>NDËRMJETËSIMI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi dhe funksionimi i shërbimeve të ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës</li> <li>• Çështjet që mund të paraqiten për t'u zgjidhur në procedurën e ndërmjetësimit</li> <li>• Parimet themelore në procedurën e ndërmjetësimit</li> <li>• Zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit</li> <li>• Kushtet e kërkuara për ndërmjetësuesit, licencimi dhe regjistrimi i tyre</li> </ul>
<b>Java e Dymbëdhjetë:</b>	<p><b>NOTERIA</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuri të përgjithshme mbi rregullat dhe sistemin notarial në Republikën e Kosovës</li> <li>• Organizimi dhe funksionimi i Noterisë në Kosovë</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtet dhe emerimi i Notereve</li> <li>• Ligji për Noterinë</li> <li>• Kompetencat e Noterit dhe procedurat para Noterit</li> </ul>
<b>Java e Trembedhjetë:</b>	<b>AVOKATIA</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Avokatia si kategori kushtetuese</li> <li>• Ligji për Avokatinë</li> <li>• Kushtet dhe emërimi i Avokatit</li> </ul>
<b>Java e Katërbëdhjetë:</b>	<b>Misionet ndërkombëtare për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga UNMIK-u deri te EULEX-i</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Struktura dhe Mandati i EULEX-it</li> <li>• Kompetencat e EULEX-it</li> </ul>
<b>Java e Pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Testi i dytë semestral</b>

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

##### **Politikat akademike në pajtim me Statutin e Universitetit të Prishtinës:**

- Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata;
- Prezenca e studentëve do të regjistrohet në listat e pjesëmarrjes, ku studentët do të vendosin firmën e tyre duke konfirmuar praninë e tyre;
- Pjesëmarrja aktive e studentëve do të vlerësohet në baza të pjesëmarrje aktive nëpërmjet interaktivitetit me Profesorin e lëndës dhe studentët e tjerë, prezantimin e temave të ndryshme dhe individuale dhe grupeve të punës ku ata mund të caktohen;
- Studentët do të kenë qasje në planin mësimor në javën e parë të semestrit ku do të familjarizohet me literaturën, si atë bazë, poashtu edhe atë dhe rekomanduar;
- Studentët janë të inkurajuar për të ngritur çështje të ndryshme për diskutim në lidhje me objektivat dhe qëllimin e lëndës;
- Studentët nuk janë të lejuar të ngrisin çështje të cilat nuk korrespondojnë me lëndën mësimore.
- Pushimet gjatë ligjëratave do të vendosen së bashku me studentët për t'i akomoduar sa më mirë nevojat e tyre.